

Kapacitetet e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit në përmbushjen e obligimeve ligjore



TITULLI:

**Kapacitetet e Agjencisë për Parandalimin e
Korrupsionit në përmbushjen e obligimeve ligjore**

AUTOR:

Lëvizja FOL

VITI I BOTIMIT:

Prill, 2023

PUBLIKUAR NGA:

Lëvizja FOL

WEBSITE:

www.levizjafol.org

ADRESA:

Andrea Gropa nr.35, Prishtinë 10000, Republika e Kosovës

Të drejtat e autorit © 2023. Lëvizja FOL. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të ruajtjes së të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë elektronike, mekanike, fotokopjuese, incizuese apo tjetër, pa pëlqimin paraprak me shkrim nga ana e botuesit.

Ky raport u realizua me mbështetjen e IFES në kuadër të projektit "Lufta Efektive Kundër Korrupsionit (ECAC)".



IFES and CEELI thank INL for their support to the IMPACTS and ECAC programs. Funding is provided for activities under these awards as a gift of the United States Government.

Përmbajtja

1. Hyrje	5
2. Metodologjia	6
3. Korniza ligjore mbi kompetencat e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit (APK)	7
4. Historiku legjislativ i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit	10
5. Sa ka kapacitete Agjencia për t'i përmbushur kompetencat e parapara me legjislacionin e ri?!	12
6. Çfarë thonë nga Agjencia për kapacitetet aktuale të këtij institucioni?!	16
7. Cilat janë veprimet e institucioneve relevante në përmbushjen e obligimeve të parapara me legjislacionin e ri?!	20
8. Konkluzion	24
9. Rekomandime	25

1. Hyrje

Praninë dhe pasojat e mëdha të korrupsionit në Kosovë po e dëshmojnë studime dhe raporte të institucioneve të specializuara ndërkombëtare, raportimet e mediave dhe hulumtimet e organizatave jo-qeveritare në Kosovë. Ndërkaq nga ana tjetër, përhapja e korrupsionit po luftohet me metoda dhe mjete nga më të ndryshmet. Organi ligjvënës i Republikës së Kosovës ka krijuar një kornizë institucionale dhe ligjore duke sjellë një sërë ligjesh, si Ligjin për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Ligjin për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik, Ligjin për Mbrojtjen e Sinjalizuesve dhe Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike.

Megjithatë, krahas këtij konstelacioni ligjor dhe institucional, në opinionin publik vazhdon të ekzistojë një pikëpamje mbi mungesën serioze të veprimeve në përmirësimin e luftës kundër korrupsionit për shkak të shumë mekanizmave institucional të mandatuar për të luftuar korrupsionin me mandate të paqarta dhe përplasje të mandateve, si dhe mungesa e llogaridhënies nga ana e institucioneve për të ndjekur siç duhet dhe për të përmirësuar implementimin e politikave kundër korrupsionit.

Nevoja për luftimin e korrupsionit si fenomen negativ, përveç që është domosdoshmëri, paralelisht reflekton edhe dëshirën për zhvillim dhe funksionim efikas të institucioneve shtetërore. Prandaj, shtetet në përbërjet e tyre institucionale parashohin organe të veçanta për luftimin dhe parandalimin e korrupsionit. Kësisoj, kompetenca të caktuara objektive dhe përgjegjësi institucionale për luftimin dhe parandalimin e korrupsionit në Republikën e Kosovës i janë besuar Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit.

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit në bazë të autorizimeve ligjore përbën organin e specializuar për zbatimin e politikave shtetërore për parandalimin e korrupsionit në Kosovë. Pra, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit është organ i pavarur i cili ndër të tjera, si objektive themelore ligjore ka shqiptimin e masave

dhe mbikëqyrjen e deklaramit të pasurisë së zyrtarëve publik, parandalimin e konfliktit të interesit, me synim parandalimin e korrupsionit, forcimin e integritetit dhe transparencës institucionale në Republikën e Kosovës, si dhe monitorimin e zbatimit të Strategjisë shtetërore dhe Planit të Veprimit Kundër Korrupsionit (tani e tutje: Strategjia kundër korrupsionit). Prandaj, duke parë këto autorizime dhe kompetenca ligjore të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, natyrshëm rrjedh nevoja për analizimin e funksionalitetit efektiv të tij. Analiza e vazhdueshme e kapaciteteve funksionale të punës së Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit nënkupton përcaktimin e veprimeve proaktive drejt evaluimit sistematik të (mos) zbatimit të suksesshëm të dispozitave ligjore nga ana e këtij institucioni.

Mirëpo krahas angazhimit të institucioneve shtetërore në luftimin e korrupsionit, perceptimi shoqëror për nivelin e lartë të pranisë së korrupsionit vazhdon të mbetet një ndër sfidat kryesore me të cilat përballet aparati shtetëror në përgjithësi dhe shoqëria kosovare në veçanti. Metodrat dhe lufta ndaj uljes së nivelit të korrupsionit doemos duhet të jenë sistematike dhe mirë e planifikuara, duke shtuar këtu harmonizimin e legjisllacionit tonë kombëtar me praktikrat e legjisllacionit të Bashkimit Evropian.

Prandaj, luftimi dhe parandalimi i kësaj dukurie negative duhet të bëhet ndërmjet bashkëveprimit institucional, të bazuar në respektimin e plotë të standardeve ligjore. Sinergjia e formuar nëpërmjet veprimit të organeve të sistemit të drejtësisë, është hapi i parë i rëndësishëm dhe thelbësor drejt luftimit të kësaj dukurie. Përveç kësaj, ngritja e kapaciteteve për institucionet e specializuara për luftimin e korrupsionit duhet të shihet si domosdoshmëri për të rritur efikasitetin dhe efektivitetin në luftën kundër korrupsionit.

2. Metodologjia

Raporti bazohet në analiza ligjore dhe politike për të vlerësuar kapacitetet reale të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit mbi dinamikën dhe mundësitë e përmbushjes së mandatit ligjor, pra kompetencat dhe përgjegjësit, në raport me rritjen e vëllimit të punëve të parapara me Ligjin për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit.

Ndërmjet rishikimit të historikut institucional të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, vlerësimit të ndryshimeve legjislative dhe analizimit të kapaciteteve funksionale dhe njerëzore të institucionit të agjencisë, mëtohet të përcaktohen kapacitetet e përgjithshme reale të këtij institucioni. Pra, qëllimi i kësaj analize është pasqyrimi i gjendjes reale sa i përket kapaciteteve aktuale të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit për funksionalizimin e mandatit të saj për parandalimin e korrupsionit.

Për të përmbushur qëllimet e këtij raporti, FOL ka përdorur metodën e analizës së legjislacionit, si dhe metodën e intervistimit dhe anketimit të zyrtarëve përgjegjës të institucioneve relevante, si dhe të personave përgjegjës të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit.

Në fillim të raportit është shtjelluar në mënyrë të përgjithshme korniza ligjore mbi bazën e të cilave Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit i ushtron kompetencat dhe përgjegjësitë, ndërsa në pjesën e dytë është trajtuar historiku i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit që nga funksionalizimi i saj si agjenci e specializuar për luftimin e korrupsionit, krahas ndryshimit të ligjeve bazë mbi të cilat janë rregulluar kompetencat e këtij institucioni.

Ndërsa në pjesën vijuese të raportit është analizuar buxheti i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, i paraparë për vitin 2023 me Ligjin mbi Ndarjet Buxhetore në raport me atë të paraparë në vitin 2022, si dhe përgjigjet e institucioneve të tjera relevante që hyjnë në kuadër të fushëveprimtarisë të Ligjit për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit.

3. Korniza ligjore mbi kompetencat e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit (APK)

Për realizimin e kompetencave dhe përgjegjësi, puna e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit bazohet në një sër aktesh ligjore dhe nënligjore. Aktet ligjore me të cilat rregullohen kompetencat e Agjencisë përfshijnë: *Ligjin për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit dhe Ligjin për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave, Ligjin për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, si dhe Ligjin për Mbrojtjen e Sinjalizuesve.*

Ndërkaq, ndër aktet nënligjore në bazën e të cilave është organizuar puna e Agjencisë, përfshihen: *Rregullorja për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Agjencinë Kundër Korrupsionit; Kodi i etikës për nëpunësit e Agjencisë Kundër Korrupsionit; Rregullorja e punës e Agjencisë Kundër Korrupsionit (e ndryshuar/plotësuar); si dhe Rregullorja për organizimin, funksionalizimin dhe menaxhimin e arkivit të Agjencisë Kundër Korrupsionit.*

Në tekstin në vijim janë shtjelluar vetëm dispozitat e Ligjit për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, si dhe të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave, ligje këto të miratuara së fundi në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

3.1 Çka parasheh Ligji i ri për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit?

Ligji nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit u miratua nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në korrik të vitit 2022. Hyrja në fuqi e këtij ligji e shfuqizoi *Ligjin nr. 03/L- 159 për Agjencinë Kundër Korrupsionit*. Finalizimi i këtij ligji ishte paraparë në

kuadër të programit legjislativ të Ministrisë së Drejtësisë për vitin 2020.

Me këtë ligj ndër të tjera qartësohet fushëveprimi i Agjencisë në fushën e parandalimit të korrupsionit, veçanërisht në fushën e hetimeve administrative në lidhje me parandalimin e konfliktit të interesit, procesit të deklarimit të pasurisë dhe dhuratave, dhe çështjet që ndërliken me sinjalizuesit.

Me ligjin e ri u ndryshua emërtimi i agjencisë, pra nga "Agjencia kundër Korrupsionit" në "Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit", dhe i njëjti u shndërrua në organ të specializuar për zbatimin e politikave shtetërore për **parandalimin** e korrupsionit në Kosovë.

Neni 5 i këtij ligji përcakton kompetencat e agjencisë. Në kuadër të këtyre kompetencave hyn zbatimi i këtyre tre ligjeve:

- *Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik,*
- *Ligji për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave, si dhe*
- *Ligji për Mbrojtjen e Sinjalizuesve*

Ndër kompetencat tjera të këtij institucioni është edhe ndërmarrja e veprimeve në fushën e monitorimit të planit të veprimit të Strategjisë Nacionale Kundër Korrupsionit, vlerësimi kundër - korrupsionit i akteve ligjore, vlerësimi i rrezikut të korrupsionit dhe planeve të integritetit; referimi i kallëzimeve penale në prokurorinë e shtetit pas informacioneve të pranuar nga personat fizik apo juridik, apo sipas detyrës zyrtare; shqiptimi i gjobave dhe ndërmarrja e masave tjera në përputhje me legjisllacionin në fuqi; mbledhja, analizimi dhe publikimi i të dhënave statistikore ose të dhënave tjera

që lidhen me gjendjen e rasteve që bien në kuadër të kompetencave të Agjencisë, zhvillimi i procedurës së hetimeve administrative, si dhe kryerja e detyrave të tjera të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit udhëhiqet nga Drejtori, i cili, ndryshe nga dispozitat e ligjit paraprak¹, emërohet me mandat 5 vjeçar pa të drejtë rizgjedhjeje.

Gjithashtu, një ndër ndryshimet esenciale të parapara në ligjin e ri në raport me ligjin që është shfuqizuar, është se tashmë *Strategjia Shtetërore dhe Plani i Veprimit Kundër Korrupsionit* hartohet dhe miratohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Në këtë rast, Agjencia merr pjesë dhe i ofron ndihmë profesionale Qeverisë në hartimin e kësaj strategjie si dhe monitoron zbatimin e saj.

Ndërkaq sipas dispozitave të ligjit paraprak, obligimin për të hartuar Strategjinë kundër Korrupsionit e kishte Agjencia në bashkëpunim me Qeverinë dhe institucionet e tjera qeveritare dhe joqeveritare, dhe i njëjti dokument do të duhej të miratohej nga Kuvendi i Kosovës.

Ligji i ri parasheh edhe obligimin e organeve të administratës qendrore, agjencive të pavarura, si dhe të autoritetet komunale të Kosovës të miratojnë plane të integritetit me qëllim të identifikimit të proceseve të ndjeshme ndaj sjelljeve dhe veprimeve që mund të jenë korruptive, të cilat duhet të nxjerrën nga institucionet publike në periudhë prej 6 muajve pas hyrjes në fuqi të akteve nënligjore të përcaktuara në këtë ligj. Ndërkaq agjencia monitoron zbatimin e këtyre planeve.

Planet e integritetit janë plane tre - vjeçare dhe përditësohen nga ana e institucionit çdo vit. Metodologjia uniforme dhe udhëzimet për përpilimin dhe zbatimin e planeve të integritetit përcaktohen me akt nënligjor të nxjerrë nga Drejtori i Agjencisë.²

Risi tjetër e paraparë në ligj është se Agjencia bën vlerësimin e rreziqeve të korrupsionit në fusha apo sektorë të ndryshëm, që konsiderohen të jenë veçanërisht të ekspozuar ndaj rreziqeve të korrupsionit apo të sugjeruar nga organizatat publike, ku sugjerimet e tyre nuk janë të detyrueshme për Agjencinë.

Gjithashtu, ligji tashmë parasheh edhe detyrimin e Agjencisë që me kërkesën e organit propozues gjatë procedurave të hartimit të projektligjeve dhe projekt akteve nënligjore të vlerësoj rreziqet dhe zbrazëtirat që potencialisht mund ta rrisin korrupsionin.

3.2 Çka parasheh Ligji i ri për Deklarimin e Pasurisë?

Në korrik të vitit 2022, Kuvendi i Republikës së Kosovës kishte miratuar edhe **Ligjin nr. 08/l-108 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave** dhe i njëjti hyri në fuqi 6 muaj pas publikimit në Gazetën Zyrtare. Hyrja në fuqi e këtij ligji e shfuqizoi *Ligjin nr. 04/l-050 për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë*.

Ndër ndryshimet më substanciale të bëra në ligjin e ri, ishte zgjerimi i gamës së personave që obligohen t'a deklarojnë pasurinë.

Përveç zyrtarëve të lartë publik, deklarimi i pasurisë është bërë obligim edhe për zyrtarë të tjerë publik, si: *“mjekët e licencuar që ushtrojnë veprimtari në institucionet publike në nivelin dytësor dhe terciar; profesorët e Universiteteve Publike, duke përfshirë profesorin asistent, profesorin e asocuar dhe profesorin e rregullt; ekspertët mjeko-ligjor dhe të psikiatrisë forenzike; auditorët e brendshëm si dhe auditorët në zyrën kombëtare të auditimit; inspektorët policor; inspektorët e nivelit qendror dhe lokal nga Zyra e Kryeministrit, ministritë, sistemi gjyqësor dhe prokurorial, agjencitë ekzekutive, agjencitë e pavarura, komisionet, inspektorët në komuna dhe rregullatorët e ndryshëm të themeluar me ligj; zyrtarët e prokurimit publik në të gjitha institucionet publike të nivelit lokal dhe qendror dhe në ndërmarrjet publike; ekspertët e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik; pozitat menaxheriale në Gjykata dhe Prokurori; zyrtarët doganor, inspektorët tatimor si dhe hetuesit policor; si dhe udhëheqësit e njësive dhe zyrtarët që*

¹ Ligji i shfuqizuar e parashihte mandatin e drejtorit të Agjencisë në kohëzgjatje prej 5 vitesh dhe mund të rizgjidhej vetëm edhe për një mandat tjetër.

² Tashmë Agjencia e ka krijuar grupin punues dhe ka filluar me krijimin e metodologjisë për përpilimin e planeve të integritetit.

kryejnë detyra hetimi, inspektimi, licencimi, verifikimi apo certifikimi në Zyrën e Kryeministrit, ministritë, sistemi gjyqësor dhe prokurorial, agjencitë ekzekutive, agjencitë e pavarura, komisionet, inspektorët në komuna dhe rregullatorët e ndryshëm të themeluar me ligj.”³

Gjithashtu, risi tjetër substanciale që është inkorporuar në ligjin e ri, është krijimi i mënyrës elektronike të deklarimit të pasurisë përmes sistemit elektronike. Pra subjektet deklaruese obligohen të deklarojnë në mënyrë elektronike pasurinë, duke përdorur sistemin e agjencisë për deklarimin elektronik të pasurisë. Agjencia do t'i mundësoj çdo zyrtari deklarues qasje të sigurt individuale në sistemin e saj elektronik për deklarimin e pasurisë.⁴ Kjo mënyrë e deklarimit të pasurisë për herë të parë u funksionalizua në deklarimin vjetor të pasurisë për vitin 2022, të bërë në mars të vitit 2023.

Deklarimi i pasurisë do të monitorohet dhe kontrollohet nga Agjencia. Agjencia pra ka qasje në të dhënat e të gjitha deklaramëve të pasurisë të subjekteve deklaruese.

Ligji gjithashtu parasheh masa të tjera ndëshkimore për kundërvajtje ndaj subjekteve deklaruese që nuk e deklarojnë pasurinë brenda kohës së paraparë në këtë ligj. Sipas nenit 23 të këtij ligji, agjencia shqipton gjobë ndaj secilit subjekt deklarues i cili nuk përmbush kërkesat brenda afatit të paraparë. Gjoba e shqiptuar do të jetë në vlerë prej 30% të pagës mujore neto të subjektit deklarues, por në asnjë rast kjo shumë nuk do të kalojë pragun prej 500 euro, me vërejtje se nëse vazhdon me kryerjen e cilësdo shkelje të paraparë me paragrafin 1 të këtij neni pas afatit shtesë prej 8 ditëve, ndaj të njëjti do të ushtrohet kallëzim penal.

Nëse subjekti deklarues, edhe pas shqiptimit të gjobës, por jo më vonë se 15 ditë kalendarike nga dita kur është dashur të përmbush detyrimin, nuk e përmbush detyrimin, atëherë Agjencia bën kallëzim penal tek prokuroria përkatëse.

³ Official Gazette of the Republic of Kosovo, Law no . 08/l-108 for Declaration, Origin and Asset and Gift Control, Article 5.

⁴ Ibid, Article 11.

4. Historiku legjislativ i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit

Përpyqjet e para të Qeverisë së Kosovës për të marrë masa në bërjen e politikave në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit, si dhe në krijimin dhe forcimin e mekanizmave përkatës startojnë qysh në vitin 2004.

Krahas këtyre përpjekjeve, u krijua edhe **Agjensioni Kosovar Kundër Korrupsionit**, ashtu siç njihej në filltet e para të krijimit të tij. Ky institucion u funksionalizuar në shkurt të vitit 2007 si institucion i pavarur për të verifikuar dhe raportuar mbi pasurinë e deklaruar të zyrtarëve shtetërorë dhe për të luftuar konfliktin e interesit.

Në atë kohë, qëllimi dhe puna e Agjencionit ishte e përqendruar në zbulimin dhe hetimin e rasteve korruptive, ndërsa detyrat dhe kompetencat ky institucion i ushtronte duke u bazuar në **Ligjin nr. 2004/34 kundër Korrupsionit**, i publikuar në Gazetën Zyrtare në mars të vitit 2007.

Aso kohe, puna e Agjencionit Kosovar Kundër Korrupsionit mbikëqyrej nga *Këshilli i Agjencionit*, i cili ishte organ kolegjal i përbërë nga nëntë anëtarë, tre prej të cilëve emëroheshin nga Kuvendi dhe nga një nga Zyra e Presidentit, Qeveria, Gjykata Supreme, Zyra e Prokurorit Publik, autoritetet lokale dhe shoqëria civile. Anëtarët e Këshillit të Agjencionit kishin mandat dy-vjeçar dhe mund të riemëroheshin.

Bazuar në kuadrin ligjor të asaj kohe, Agjensioni në mënyrë të detyrueshme raportonte tek Këshilli i Agjencionit çdo gjashtë muaj në lidhje me përmbajtjen dhe shtrirjen e mbikëqyrjes së pasurive dhe dhuratave si dhe për gjetjet e Agjencionit në lidhje me papajtueshmërinë, konfliktin e interesave dhe hetimet e përfunduara, si dhe punën dhe

aktivitetet e detajuara të kryera nga Agjensioni gjatë periudhës së raportuar.

Agjensioni ishte i përbërë nga tre departamente: Departamenti për Strategjinë Anti-korrupsion dhe Hetimet Administrative; Departamenti i Parandalimit të Korrupsionit si dhe Departamenti i Shërbimeve Administrative.

Gjatë kësaj kohe, Agjensioni është përballur me probleme substanciale, që kanë pasur ndikim në përmbushjen e misionit të institucionit. Ndër problemet e theksuara gjatë asaj kohe, ishin: numri i vogël i zyrtarëve dhe pamundësia e rekrutimit të personelit shtesë si rezultat i buxhetit të limituar, niveli i pagave të stafit të Agjencionit, koordinim jo i kënaqshëm me Prokuroritë, mungesa e hapësirës së punës etj.⁵

Në vitin 2009 u miratua *Ligji nr. 03/l-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit*, me të cilin u ndryshua emërtimi i këtij institucioni në **"Agjencinë kundër Korrupsionit"**.

Ligji për Agjencinë kundër Korrupsionit përcaktonte statusin dhe përgjegjësitë e këtij institucioni në fushën e luftimit dhe parandalimit të korrupsionit, veçanërisht në fushën e raportimit, zbulimit dhe hetimit të korrupsionit, zbatimit të Strategjisë Kundër Korrupsionit. Gjithashtu, ndryshe nga ligji paraprak, ku puna e Agjencionit Kosovar kundër Korrupsionit mbikëqyrej nga *Këshilli i Agjencionit*, me ligjin e ndryshuar puna e Agjencisë kundër Korrupsionit mbikëqyrej nga Komisioni për Legjisllacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, i themeluar nga Kuvendi i Kosovës. Ligji i ri i kufizonte kompetencat e agjencisë

5 Kosova Anti-Corruption Agency, Annual Report of the Kosova Anti-Corruption Agency, January 1- December 31, 2007

në kryerjen e "hetimeve paraprake", ndërsa hetimet penale të parapara në ligjin e ri mbeten në kompetencë të prokurorisë.

Agjencia kundër Korrupsioni vazhdoj të funksionoj me këto kompetenca dhe me këtë emërtim deri në gusht të

vitit 2022, kur u miratua **Ligji Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit** (ndryshimet e të cilit janë përshkruar në kapitullin e kornizës ligjore), dhe përveç emërtimit, u ndryshuan edhe disa prej kompetencave të këtij institucioni (ndryshimet e të cilit janë shtjelluar në Kapitullin 3 të këtij raporti).

5. Sa ka kapacitete Agjencia për t'i përmbushur kompetencat e parapara me legjislacionin e ri?!

Kompetencat dhe përgjegjësitë e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit janë rritur në masë të madhe me hyrjen në fuqi të Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe me dispozitat e Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave

Kjo rritje e përgjegjësiave ndikohet veçanërisht nga rritja e subjekteve / zyrtarëve publik të cilët obligohen t'a deklarojnë pasurinë. Pra, krahas rreth 5,000 zyrtarëve publik që janë të obliguar të deklarojnë pasurinë, me dispozitat e Ligjit të ri për Deklarimin e Pasurisë që pritet të hyjnë në fuqi në gusht të vitit 2023, ky numër i zyrtarëve që do të obligohen t'a deklarojnë pasurinë, do të rritet në rreth 20,000 zyrtarë.

Ndërkaq dispozitat e Ligjit për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit që kanë të bëjnë me krijimin e aktit nënligjor për *krijimin e metodologjisë uniforme për përpilimin dhe zbatimin e planeve të integritetit, krijimin e aktit nënligjor për përcaktimin e metodologjisë së vlerësimit të rrezikut nga korrupsioni, si dhe akti nënligjor për përcaktimin e metodologjisë për vlerësim të potencialit të korrupsionit në legjislacion*, hyjnë në fuqi gjithashtu në gusht të vitit 2023, përkatësisht 1 vit pas hyrjes në fuqi të vetë ligjit.

Puna në drejtim të përpilimit të aktit nënligjor për krijimin e metodologjisë uniforme për përpilimin e planeve të integritetit ka filluar, prandaj mbetet të shihet nëse do të arrihet finalizimi i saj brenda kohës së paraparë.

Pas krijimit të këtyre akteve nënligjore dhe 6 muaj pas hyrjes në fuqi të tyre, përkatësisht në muajin shkurt të vitit 2024, Agjencia do të fillojë monitorimin e zbatimit të planeve të integritetit të formuara nga institucionet qendrore, lokale dhe agjencionet e pavarura, të bëjë vlerësimin e rreziqeve të korrupsionit në fusha apo sektorë të ndryshëm, si dhe të bëjë vlerësimin e rreziqeve

dhe zbrazëtirave që potencialisht mund ta rrisin korrupsionin, të bëra me kërkesën e organit propozues.

Por pavarësisht rritjes së punëve dhe përgjegjësiave të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit të bëra nga Kuvendi i Kosovës, organi ligjvënës ka paraparë rritje minimale për buxhetin e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit për vitin 2023.

Sipas Ligjit për Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, buxheti total i këtij institucioni ishte 545,778.00 €, ndërsa sipas Ligjit për Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, ky buxhet është paraparë 557,844.00 €, pra me rritje vetëm për 12,066 €.

Bazuar në Ligjin mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, buxheti i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit për vitin 2023 është rritur vetëm për

në krahasim me buxhetin paraprak vjetor (vitin 2022), që shprehur në përqindje përfshin rritjen vetëm për



€12,066

Ose

↑ 2.21 %

Pra, kjo nënkupton se Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, si shkak i kostos buxhetore, do ta ketë të pamundur të realizoj obligimet që i janë shtuar me ligjet e ndryshuara.

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur Buxheti i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit i paraparë për vitin 2022 dhe 2023, duke përfshirë pagat dhe shtesat, mallrat dhe shërbimet, shpenzimet komunale dhe shpenzimet kapitale, si dhe rritja e paraparë e buxhetit ndërmjet viteve përkatëse.

Viti fiskal	Paga dhe shtesa	Mallra dhe shërbime	Shpenzime komunale	Shpenzime kapitale	Buxheti total
2022	€ 413,222	€ 114,056	€ 8,500	€ 10,000	€545,778
2023	€ 415,288	€ 114,056	€ 8,500	€ 20,000	€557,844
Rritja e buxhetit	↑ €2,066	€ 0	€ 0	↑ € 10,000	↑ €12,066

Tabela 1. Buxheti i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit për vitin 2022 dhe 2023 i paraparë në Ligjet mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitet përkatëse.

Pra, bazuar në tabelën e vendosur më sipër, rritja e buxhetit është reflektuar vetëm tek shpenzimet kapitale, përkatësisht 10,000 euro më shumë se në vitin 2022, dhe tek pagat dhe mëditjet, ku buxheti është rritur për 2,066 euro. Ndërsa tek mallrat dhe shërbimet, si dhe tek shpenzimet komunale, ndarja buxhetore është paraparë në mënyrë të njëjtë sikurse në vitin e kaluar.

Sipas *Ligjit për Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e vitit 2023*, përkatësisht sipas Tabelës 3.2 (Projekt kapitalet për nivel qendror)⁶, investimet kapitale përfshijnë vetëm blerjen e kabinetit dhe UPS-së të serverëve (ku do të shpenzohen 10,000 euro), zhvillimin e ueb-faqes së agjencisë (ku do të shpenzohen 6,000 euro), si dhe blerjen e pajisjeve të teknologjisë informative – laptop (ku do të shpenzohen 4,000 euro).



Gjithashtu, pavarësisht shumëfishimit të vëllimit të punëve të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, numri i të punësuarve në këtë institucion edhe gjatë vitit 2023 do të vazhdoj të mbetet i njëjtë sikurse në vitin paraprak, pra vetëm 43 të punësuar.

FOL ka kërkuar nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit përgjigje në atë se si është destinuar shfrytëzimi i rritjes minimale të buxhetit të këtij institucioni prej 12,066 Euro për vitin 2023. Në lidhje me këtë çështje, zyrtarët e këtij institucioni janë përgjigjur:

“Nga buxheti i rritur prej 12,066 Euro:

a) 2,066 të buxhetit shtesë janë të destinuar për mbulimin e shtesës vjetore të përvojës së punës për një vit për të gjitha pozitat e aprovuara për APK (gjithsej 43 pozita);

b) 10,000 Euro të buxhetit janë të destinuar për 2 projekte kapitale (furnizim me të mira materiale që e kanë si njësi vlerën më shumë se 1000 Euro dhe që afatin e shfrytëzimit e kanë më shumë se 1 vit si dhe për krijimin dhe dizajnimin e ueb faqes së Agjencisë dhe furnizimi me laptop për nevoja të Agjencisë”.

Gjithashtu, zyrtarët e këtij institucioni kanë shtuar se:

“Në vitin 2023, për sa i përket Sistemit Elektronik të Deklarimit të Pasurisë jemi duke u përkrahur nga UNDP dhe duke u mbuluar me punën jashtë orarit të stafit aktual të IT – së prej një zyrtari, si dhe zyrtarëve tjerë të deklaramit të pasurisë”.

Pra nga përgjigjet e këtij institucioni, shihet se buxheti i paraparë për këtë institucion për vitin 2023 nuk arrin të mbuloj shpenzimet e krijuara të këtij institucioni me miratimin e legjislacionit të ri, dhe obligimet e njëjta duhet të mbulojnë nga përkrahja e partnerëve ndërkombëtar.

⁶ Ligji për Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, Tabela 3.2 Projektet Kapitale për Nivelin Qendror.

6. Çfarë thonë nga Agjencia për kapacitetet aktuale të këtij institucioni?!

Për t'u njohur për nga afër me kërkesat e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit në lidhje me përmbushjen e objektivave institucionale dhe përgjegjësitë e parapara me legjislacionin në fuqi, Lëvizja FOL ka komunikuar me zyrtarët përgjegjës për komunikim me publikun të këtij institucioni. Komunikimi është bërë përmes pyetësorëve dhe intervistave plotësuese me shkrim.

Në pyetjen e parashtruar nga FOL në lidhje me atë se sa ka kapacitete njerëzore dhe funksionale agjencia për përmbushjen e obligimeve të parapara në ligjin e ri, zyrtarët e këtij institucioni kanë thënë:



Kapacitetet njerëzore të Agjencisë aktualisht mbulojnë minimalisht nevojat për kryerjen e obligimeve ligjore të Agjencisë në raport me zbatimin e kornizës ligjore që ka në mandatin e saj. Agjencia ka dorëzuar kërkesa për burime njerëzore shtesë dhe për përkrahje financiare dhe jo-financiare".



Gjatë vitit 2022, marrë për bazë rritjen e numrit të kërkesave që ka rritur gjithashtu dyfish numrin e veprimeve, sfida kryesore e Agjencisë ishte mungesa e resurseve kadrovike dhe pamjaftueshmëria e buxhetit, e cila deri diku është mbuluar me përkrahjen e donatorëve. Puna e Agjencisë besojmë që ka kontribuar pozitivisht në përmirësimin e rangimit të Kosovës në raport me parandalimin e korrupsionit dhe luftimit të tij në raporte kredibile ndërkombëtare. Si rezultat i rritjes së dinamikës së veprimeve të Agjencisë, transparencës dhe politikës së dyerve të hapura për parandalimin dhe luftimin e Korrupsionit, shënoi rritje edhe numri i raportimeve dhe kërkesave dhe rezultoi të përfundojë me dyfishin e rasteve të trajtuara në krahasim më dy vitet e mëparshme."

Në lidhje me pyetjen se cila ka qenë sfida më e madhe e këtij institucioni sa i përket përmbushjes së qëllimeve institucionale, nga agjencia janë përgjigjur:

Në lidhje me pyetjen e FOL se a është i mjaftueshëm buxheti i agjencisë për të arritur objektivat dhe përgjegjësitë e parapara me ligjin e ri, zyrtarët e këtij institucioni janë përgjigjur:



Jo. Sfida kryesore e Agjencisë është mungesa e kapaciteteve njerëzore, teknike dhe mungesa e buxhetit, natyrisht për të arritur zbatimin e objektivave dhe qëllimeve të saj për parandalimin e korrupsionit në Kosovë. Dihet botërisht që Agjencia është e obliguar që të zbatoj deklarin elektronik të pasurisë, proces ky që ka nevojë për buxhet adekuat dhe staf profesional shtesë qoftë në fushën e TIK-ut apo hetimeve me qëllim verifikimi të deklarin. Pastaj, kërkohet që Agjencia të kryej funksione shtesë siç janë shqyrtimi kundër korrupsionit i legjislacionit, planet e integritetit, strategjia kombëtare kundër korrupsionit etj.. Pra, buxheti i ndarë për Agjencinë nuk është mjaftueshëm por Agjencia është në kontakt të vazhdueshëm me institucionet përgjegjëse që buxheti i Agjencisë t'i mbulojë kërkesat dhe nevojat për zbatimin e obligimeve ligjore të Agjencisë."

Në pyetjen e FOL se cilat janë kërkesat e agjencisë sa i përket zhvillimit institucional dhe ngritjes së kapaciteteve të brendshme, zyrtarët e këtij institucioni janë përgjigjur:



Kërkesat e Agjencisë për ngritjen e kapaciteteve janë të orientuara në përmbushjen e obligimeve ligjore për të zbatuar kompetencat e reja të Agjencisë që lidhen me kompetencat e reja në fushën e deklarin të pasurisë, dyfishimin e numrit të subjekteve deklaruese, shqyrtimin e gjobave, parandalimin e korrupsionit në draftimin e ligjeve dhe akteve nën-ligjore, monitorimin e zbatimit

të planit të integritetit të institucioneve. Natyrshëm se për zbatimin e këtyre obligimeve Agjencia nuk ka kapacitete të mjaftueshme njerëzore për t'i zbatuar këto përgjegjësi, qoftë në kuptim të numrit të stafit gjithashtu edhe të ekspertizës profesionale".

Pra, sipas përgjigjeve të zyrtarëve përgjegjës të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, kapacitetet aktuale të agjencisë nuk i përmbushin kërkesat për përmbushjen e obligimeve ligjore. Krahas kompetencave të shtuara të Agjencisë në fushën e deklarin të pasurisë, shqyrtimin e gjobave, monitorimin e planeve të integritetit dhe parandalimin e korrupsionit gjatë hartimit të legjislacionit primar dhe sekondar, struktura aktuale e Agjencisë vazhdon të mbetet e njëjta. Rrjedhimisht, Agjencia vazhdon punën me stafin që e kishte para plotësim/ndryshimeve të reja legjislative, ndërsa kërkesa për plotësime të stafit vazhdon të mbetet ende e pa aprovuar nga institucionet kompetente.

Lëvizja FOL ka parashtruar pyetje edhe në lidhje me numrin e zyrtarëve të Agjencisë të cilët kryejnë nga dy e më shumë detyra brenda agjencisë. Në lidhje me këtë çështje, zyrtarët e këtij institucioni kanë thënë se janë 5 zyrtarë të agjencisë që brenda këtij institucioni kryejnë edhe detyra shtesë, si: funksione financiare, shpenzues, certifikues, zyrtarë pasurie etj..

Ndërsa në pyetjen e FOL se sa zyrtarë të Agjencisë janë të angazhuar me punë jashtë këtij institucioni, zyrtarët e APK-së janë përgjigjur se janë 7 zyrtarë me pozita të caktuara që krahas punës që e bëjnë në APK, janë të angazhuar edhe në punë të tjera. Në rrudhën e këtyre pozitave, janë përmendur:

- Pozita e Udhëheqësit të Prokurimit, që është angazhuar në Organin Shqyrtues të Prokurimit si ekspert i jashtëm. Ndërkaq sipas Rregullores për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Agjencinë Kundër Korrupsionit, Udhëheqësi i Prokurimit organizon, udhëheqë dhe mbikëqyrë punët dhe aktivitetet e prokurimit, si dhe kryen detyra të tjera të përcaktuara me këtë rregullore.

- Pozita e Zyrtarit të lartë për parandalim të konfliktit të interesit, i cili është angazhuar si trajner (sipas kërkesës) në Institutin e Kosovës për Administratë Publike (IKAP). Sipas rregullores, zyrtari i lartë për parandalimin e konfliktit të interesit ka këto detyra dhe përgjegjësi: identifikon rastet e mundshme të konfliktit të interesit të zyrtarëve të lartë të përcaktuar sipas ligjit në fuqi; zhvillon procedurën për hetimin e rasteve të konfliktit të interesit; si dhe kryen detyra të tjera të përcaktuara me këtë rregullore.
- Pozita e Administratorit të Lartë të IT-së për Sisteme, i cili është angazhuar (part time) si ligjërues në PBC Academy (institucion privat). Sipas rregullores, kjo pozitë në agjenci ka këto përgjegjësi: dizajnon, zhvillon dhe instalon sistemet e ndryshme të teknologjisë informative; analizon programet e reja me ato ekzistuese duke bërë paraprakisht testimin për përshtatshmëri me pajisjet e teknologjisë informative; si dhe kryen detyra të tjera të përcaktuara me këtë rregullore.
- Pozita e Drejtorit të Departamentit për Parandalim të Korrupsionit – i cili është angazhuar si Trajner i Certifikuar nga IKAP mbështetur nga Këshilli i Evropës, projekti PECK III, në fushat 'Mbrojtja e të drejtave të sinjalizuesve". Sipas rregullores, detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit të këtij departamenti janë: udhëheqë dhe organizon punën e departamentit dhe është përgjegjës për punën e gjithmbarshme të Departamentit për Parandalimin e Korrupsionit (DPK); mbikëqyrë procesin e deklarimit të pasurisë dhe dhuratave, parandalimin e konfliktit të interesit dhe korrupsionit në prokurimin publik dhe korrupsionit në tërësi, si dhe kryen detyra të tjera të përcaktuara me rregulloren në fuqi.
- Pozita e Drejtorit të Departamentit për Luftimin e Korrupsionit, i cili është i angazhuar në Institutin e Kosovës për Administratë Publike si Trajner për trajnimin e të punësuarve në administratën publike. Sipas rregullores, detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit të këtij departamenti

janë: udhëheqja dhe organizimi i punës së departamentit; mbikëqyrja e punës së zyrtarëve të departamentit; të marrë pjesë në nismat legislative që kanë të bëjnë me parandalimin dhe luftimin e korrupsionit, si dhe kryen detyra të tjera të parapara me rregulloren në fuqi.

- Pozita e Zyrtarit të Lartë për Hetime dhe Analiza, i cili është angazhuar jashtë APK-së në Kompaninë private "IPSOS si RED". Sipas rregullores, kjo pozitë ka këto përgjegjësi: zhvillon procedurën e hetimeve paraprake për rastet të cilat i caktohen nga shefi i divizionit; në bashkëpunim me shefin e divizionit përcakton mënyrën e zhvillimit të hetimeve paraprake; informon shefin e divizionit për fazat e hetimit dhe rastet e mundshme të korrupsionit; përgatitë kallëzime penale, vendime për shkelje administrative dhe vendime për mbylljen e rasteve, si dhe kryen detyra të tjerat të përcaktuara me rregullore.

Po ashtu, sipas përgjigjeve të pranuara, janë edhe dy zyrtarë që i ruajnë pozitën në Agjenci sipas Ligjit për Zyrtarët Publik, njëri prej të cilëve është Deputet i Kuvendit të Kosovës, ndërsa tjetri në mision diplomatik.

Pra, përkundër faktit se Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit përballet me vështirësi në kuptim të mungesës së resurseve njerëzore, në këtë institucion ka zyrtarë të cilët krahas ushtrimit të funksioneve mjaftë të rëndësishme në agjenci, kryejnë edhe funksione të tjera jashtë këtij institucioni.

Kjo padyshim se ndikon në mënyrë të konsiderueshme në efikasitetin në kryerjen e detyrave dhe funksioneve të tyre në kuadër të fushëveprimtarisë së Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit. Pra, natyrshëm lind pyetja se a do të arrijnë këta zyrtarë që kanë punë sekondare, të përmbushin plotësisht detyrat e tyre në institucionin ku ka mungesë të theksuar të resurseve njerëzore.

Në fund, sipas përgjigjeve të pranuar nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, kërkesa e këtij institucioni mbetet:



“Numri i stafit të shtohet për **15 në vitin 2023 dhe 10 në vitin 2024 (total 25 staf)**

Buxheti për paga të shtohet për **139,320.00 Euro në vitin 2023 dhe 95,000.00 Euro në vitin pasues, 2024.**

Buxheti për mallra dhe shërbime të shtohet për **10,000.00 EUR** për 2023 dhe të vazhdoj me trend të rritjes edhe në vitet në vijim.

Të përmirësohet infrastruktura e objektit”.

Por pavarësisht këtyre kërkesave, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit vazhdon punën me kapacitete të pandryshuara, krahas rritjes së vëllimit të punëve dhe përgjegjësive.

7. Cilat janë veprimet e institucioneve relevante në përmbushjen e obligimeve të parapara me legjislacionin e ri?!

Për nevojat e këtij hulumtimi, FOL u ka dërguar pyetje zyrtarëve përgjegjës të disa institucioneve shtetërore, duke pyetur për (1) obligimet e reja, detyrimet dhe nevojat e tyre për komunikim/koordinim me Agjencinë për Parandalimin në mandatin e saj të zgjeruar; si dhe (2) statusin e iniciativave të ndryshme në lidhje me Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit.

Institucionet e kontaktuara përfshijnë: Qeverinë e Kosovës; Komisionin për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit (tani e tutje: Komisioni për Legjislacion); Ministrinë e Drejtësisë; si dhe Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve.

7.1 Qeveria e Kosovës

Institucionet e Republikës së Kosovës edhe pas një periudhe të gjatë kohore, përkatësisht pas më shumë se 4 vitesh, po vazhdojnë të kenë mungesë të Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Luftimin e Korrupsionit.

Strategjia e fundit e hartuar, e titulluar *“Strategjia Kombëtare Kundër Korrupsionit 2018-2022”*⁷, ishte miratuar nga Qeveria e Kosovës me 23 mars të vitit 2018. Në vendimin e nxjerrë për miratimin e këtij dokumenti⁸, Qeveria kishte obliguar Agjencinë kundër Korrupsionit dhe institucionet tjera kompetente në zbatimin e tij, dhe ishte paraparë se kjo strategji hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

Mirëpo, ky veprim i Qeverisë binte ndesh me Ligjin për Agjencinë kundër Korrupsionit, i cili ishte në fuqi në atë kohë. Ky ligj, në paragrafin 2 të nenit 16 të tij, përcaktonte se:



Agjencia përmes Qeverisë paraqet për miratim Strategjinë kundër Korrupsionit në Kuvendin e Kosovës, dokument i cili përmban politikat kundër korrupsionit që duhet të zbatohen nga institucionet përgjegjëse të Republikës së Kosovës, si në nivel qendror ashtu edhe në atë lokal.”

Nga ky paragraf shihet qartë se obligimin për t'a miratuar Strategjinë Kombëtare Kundër Korrupsionit e kishte Kuvendi i Kosovës, e jo Qeveria e Kosovës.

Pra Qeveria e Kosovës kundërligjshëm i ka zbatuar kompetencat e Kuvendit të Kosovës me rastin e miratimit të Strategjia Kombëtare Kundër Korrupsionit 2018-2022, dhe rrjedhimisht Republika e Kosovës për më shumë se 4 vite formalisht nuk ka ndonjë dokument strategjik për luftimin e korrupsionit.

Ndërsa me ndryshimet e bëra pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, kompetencat e miratimit të Strategjisë Shtetërore dhe Plani I Veprimit kundër Korrupsionit ka kaluar nga

⁷ Për më shumë, shih: https://ëëë.akk-ks.org/lajmi_i_plote/443.

⁸ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Qeveria e Kosovës, Vendimi nr.02/37, datë 23.03.2018.

Kuvendi i Kosovës të Qeveria e Kosovës⁹, ku kjo e fundit tashmë ka nxjerrë vendimin për themelimin e strukturave përgjegjëse për hartimin e strategjisë.¹⁰

Prandaj FOL ka parashtruar pyetje tek zyrtarët përgjegjës të këtij institucioni se cilat janë veprimet që Qeveria i ka ndërmarrë për ta përbushur këtë obligim ligjor.

Zyrtarët përgjegjës të këtij institucioni janë përgjigjur se:



"Qeveria e Republikës së Kosovës e ka miratuar vendimin për themelimin e strukturave përgjegjëse për hartimin e Strategjisë për Luftimin e Korrupsionit - Vendimi i Qeverisë Nr. 06/130, i datës 22.02.2023".

Pra, Qeveria e Kosovës është përgjigjur se janë krijuar strukturat përgjegjëse për hartimin e Strategjisë. Kjo nënkupton që procesi i hartimit të strategjisë mund të vlerësohet se është ende në faza fillestare, duke marrë parasysh se është nxjerrë vetëm Vendimi 06/130 i datës 22.02.2023, mirëpo nuk ende është ndërmarrë ndonjë veprim konkret në drejtim të ideimit dhe përcaktimit të politikave shtetërore, si dhe propozimin e masave dhe aktiviteteve konkrete në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit.

Sipas këtij vendimi, ky dokument do të finalizohet me 1 dhjetor të vitit 2023. Mirëpo, duke e ditur se punimet për të hartuar këtë dokument strategjik nuk kanë filluar ende, natyrshëm rrjedh pyetja se a do të mund të finalizohet ky dokument brenda periudhës kohore të paraparë.

7.2 Komisioni për Legjislacion

Bazuar në dispozitat e ligjit në fuqi, Komisioni për Legjislacion mbikëqyrë punën e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, shqyrton raportet e

agjencisë, mbikëqyrë dhe vlerëson në mënyrë periodike punën e Drejtorit të Agjencisë, inicicion procedurën për zgjedhjen dhe shkarkimin e Drejtorit të Agjencisë, si dhe kontrollon dhe mbikëqyr pasurinë e deklaruar nga zyrtarët e lartë të Agjencisë si dhe trajtimin e çështjeve të konfliktit të interesit.¹¹

Prandaj, FOL ka parashtruar pyetje tek zyrtarët përgjegjës të Komisionit për Legjislacion në lidhje me obligimet e këtij institucioni sipas ligjit në fuqi.

Në pyetjen e FOL se a ka bërë Komisioni për Legjislacion ndonjë analizë të vlerësimit të nevojave të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit pas miratimit të Ligjit të ri për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, zyrtarët përgjegjës të këtij institucioni janë përgjigjur kështu:



Deri më tani Komisioni për Legjislacion nuk ka bërë ndonjë analizë të vlerësimit të nevojave të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit."

Në lidhje me pyetjen se, a ka kërkuar Komisioni për Legjislacion raportim nga Qeveria e Kosovës në lidhje me obligimin për të hartuar Strategjinë kundër korrupsionit, zyrtarët përgjegjës të Komisionit janë përgjigjur:



Deri tani Komisioni për Legjislacion nuk ka kërkuar nga Qeveria raportim lidhur me këtë obligim."

Në pyetjen se a ka paraqitur kërkesa buxhetore Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit në Komisionin për Legjislacion pas miratimit të legjislacionit të ri, zyrtarët përgjegjës të Komisionit për Legjislacion janë përgjigjur:

9 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, neni 24.

10 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Qeveria e Kosovës, Vendimi nr.06/130, datë 22.02.2023.

11 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, neni 16.



Në mbledhjen e mbajtur më 30 dhjetor 2022, pas shqyrtimit të kërkesave buxhetore të institucioneve që bien në fushëveprim të tij, kishte paraqitur propozim-amendamentet në Projektligjin nr. 08/L-193 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, si vijon:

Amendamenti 1: Të ndahen mjete shtesë për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, me kodin organizativ 236 dhe me kodin e programit (nënprogramit) 20400, në shumën prej 80,000.00 €, në kuadër të kategorisë ekonomike, paga dhe mëditje dhe 10,000.00 €, në kuadër të kategorisë ekonomike, mallra dhe shërbime."

Pra zyrtarët e Komisionit për Legjislacion kishin vlerësuar se është e nevojshme të përkrahet Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, në tërësi, në shumën totale prej 90,000.00 €, në kategorinë ekonomike, paga dhe mëditje dhe në kategorinë ekonomike mallra dhe shërbime. Kjo për faktin se, siç kanë shpjeguar zyrtarët e këtij institucioni, Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit i janë zgjeruar kompetencat dhe dukshëm i janë rritur përgjegjësitë me hyrjen në fuqi të Ligjit për Agjencinë e Parandalimit të Korrupsionit dhe Ligjit nr. 08/L-108 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave dhe është e nevojshme të mbulohen 15 pozita të reja për vitin 2023.

Mirëpo më tutje, zyrtarë e Komisionit për Legjislacion kanë theksuar:



Mirëpo Kuvendi nuk e ka përkrahur këtë amendament."

Në pyetjen e FOL se përveç raportimeve të detyrueshme që janë përcaktuar me ligj, a ka kërkuar Komisioni për Legjislacion raportim Ad-Hoc nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit për zbatimin e ligjit të ri, zyrtarët përgjegjës të Komisionit janë përgjigjur:



Deri tani Komisioni për Legjislacion nuk ka kërkuar raportim ad-hoc nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit."

Në pyetjen e FOL se me çfarë metodologjie do të bëhet verifikimi i deklarimit të zyrtarëve të Agjencisë, zyrtarët përgjegjës të Komisionit janë përgjigjur:



Komisioni nuk ka diskutuar për këtë çështje, e cila pritet të diskutohet pasi që të përfundoj afati ligjor për deklarim të pasurisë."

7.3 Ministria e Drejtësisë

Lëvizja FOL ka parashtruar pyetje edhe në Ministrinë e Drejtësisë në lidhje me obligimin këtij institucioni, të paraparë në "Rregulloren nr. 03/2021 për Përcaktimin e Procedurës për Pranimin dhe Trajtimin e Rasteve të Sinjalizimit" që në bashkëpunim me Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit në afat prej 6 muajsh pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje të hartoj udhëzues për:

"mbrojtjen që ju ofrohet personave që dorëzojnë raportimet në interes publik;

obligimet e punëdhënësve për të mbrojtur sinjalizuesit nga aktet e dëmshme dhe të drejtën e sinjalizuesve për mbrojtje gjyqësore dhe mënyrën e kryerjes së hetimit administrative".

Në lidhje me këtë çështje, Ministria e Drejtësisë është përgjigjur:



Ministria e Drejtësisë, në bashkëpunim me Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit dhe me mbështetje të projektit PECK III të Zyrës së Këshillit të Evropës është në proces të hartimit të Projekt Udhëzuesve që rrjedhin nga Rregullorja përkatëse. Shumë shpejt Projekt Udhëzuesit do të diskutohen dhe finalizohen me akterët relevant."

Pra, edhe pse Rregullorja ka hyrë në fuqi në maj të vitit 2021, dhe udhëzimi do të duhej të nxirrej në nëntor të vitit 2021, ky udhëzim nuk është finalizuar ende nga institucionet kompetente.

7.4 Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve

Lëvizja FOL ka parashtruar pyetje edhe në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve në lidhje me kërkesat shtesë buxhetore të cilat i ka pasur Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit për vitin 2022 dhe se sa janë plotësuar këto kërkesa buxhetore.

Në lidhje me këtë, zyrtarët përgjegjës të Ministrisë së Financave janë përgjigjur:



APK ka paraqitur kërkesë shtesë për rritje të numrit për 4 pozita të reja të cilat ishin të aprovuara me Ligjin e Buxhetit për vitin 2019 si dhe kthimin e masës monetare për këto pozita. Kërkesa për rritje të numrit të punëtorëve është paraqitur me arsyetimin e ngritjes së kapaciteteve njerëzore. Kërkesa shtesë monetare nuk është paraqitur."

APK ka paraqitur kërkesë shtesë për sa i përket teknologjisë informative si: Blerja e 2 UPS për server në vlerë prej 7,000 euro dhe Blerja e RACT Monter-42 Unit në vlerë prej 3,000 euro."

"

Sipas Ministrisë së Financave, arsyetimi i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit për parashtrimin e këtyre kërkesave ka qenë: bazuar në marrëveshjen për donacione ndërmjet mbështetjes nga Byroja për Çështje Ndërkombëtare të Narkotikeve dhe Zbatimit të Ligjit (INL) në Ambasadën Amerikane në Prishtinë, APK ka pranuar pajisje për dhomën e serverëve. Mirëpo pajisjet nuk janë instaluar për shkak se nevojiten blerja e 2 UPS-ve dhe blerja e RACT Monter-42 Unit.

Gjithashtu, Ministria e Financave ka shtuar se:



Kërkesë tjetër e APK-së është edhe përmirësimi i infrastrukturës së ndërtesës së AKK-së (hapësira e pamjaftueshme) për të cilën nuk është paraqitur masa monetare."

Pra, sipas Ministrisë së Financave, me Ligjin Nr. 08/L-066 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit i ishte rritur buxheti në investime kapitale në vlerë prej 10,000 euro për reflektimin e kërkesës shtesë.

Rrjedhimisht, institucionet përkatëse sikurse Komisioni për Legjislacion, Qeveria e Kosovës, Ministria e Drejtësisë si dhe Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve duhet të ndërmarrin hapa më serioz në drejtim të mbështetjes së nevojshme shtetërore ndaj Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, si dhe në kryerjen e obligimeve që ju ngarkohen me legjislacionin në fuqi.

8. Konkluzion

Nga analizimi metodik i legjislacionit pozitiv, si dhe hulumtimi i perceptimit të institucioneve relevante, mund të nxjerrim këto konkluzione:

- Pavarësisht shumëfishimit të vëllimit të punëve dhe rritjes së përgjegjësiave të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit me miratimin e Ligjit nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit dhe Ligjin nr. 08/L-108 për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave, për këtë institucion për vitin 2023 ishte paraparë një rritje minimale e buxhetit.
- Buxheti i vitit 2023 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit është paraparë 545,778.00 €, përkatësisht 2.21% më shumë se në vitin 2022, ku përgjegjësitë dhe obligimet ligjore të këtij institucioni ishin dukshëm më të pakta në raport me ato të cilat janë paraparë me ligjin e ri. Pra, planifikimi buxhetor i bërë nga Qeveria e Kosovës dhe i miratuar nga Kuvendi i Kosovës nuk i përmbush nevojat dhe kërkesat e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, prandaj në mënyrë imanente, ky buxhet duhet të rritet pas rishikimit të tij gjatë vitit 2023.
- Gjithashtu, pavarësisht shumëfishimit të vëllimit të punëve të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, numri i të punësuarve në këtë institucion edhe gjatë vitit 2023 do të vazhdoj të mbetet i njëjtë sikurse në vitin paraprak, pra vetëm 43 të punësuar. Pra, agjencia vazhdon punën me stafin që e kishte para plotësim/ndryshimeve legjislative, ndërsa kërkesa për plotësime të stafit vazhdon të mbetet ende e pa aprovuar nga institucionet kompetente.
- Edhe Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit ka theksuar se për zbatimin e obligimeve shtesë, agjencia nuk ka kapacitete të mjaftueshme njerëzore, si në kuptim të numrit të stafit, ashtu edhe të ekspertizës së nevojshme profesionale.
- Për të përmbushur obligimet ligjore, kërkesat e agjencisë janë që numri i stafit të shtohet për 15 në vitin 2023 dhe 10 në vitin 2024 (total 25 staf); ndërsa buxheti për paga të shtohet për 139,320.00 euro në vitin 2023 dhe 95,000.00 euro në vitin 2024, si dhe të përmirësohet infrastruktura e objektit. Kjo padyshim se ndikon në efikasitetin e kryerjes së detyrave dhe funksioneve të këtij institucioni.
- Prej këtyre 43 zyrtarëve të angazhuar në agjenci, janë 5 zyrtarë që brenda këtij institucioni kryejnë edhe detyra shtesë, si: funksione financiare, shpenzues, certifikues, zyrtarë pasurie etj., si dhe 7 zyrtarë që kryejnë funksione të tjera jashtë këtij institucioni, si: ligjërues, trajnerë apo angazhime të tjera në kompani private.
- Edhe Komisioni për Legjislacion kishte vlerësuar se Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit është e nevojshme të përkrahet në shumën totale prej 90,000.00 € në kategorinë ekonomike, paga dhe mëditje dhe në kategorinë ekonomike mallra dhe shërbime, mirëpo Kuvendi i Kosovës nuk e kishte përkrahur këtë amandament.
- Sa i përket përcaktimit të politikave shtetërore për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit, Institucionet e Republikës së Kosovës tash e 4 vite vazhdojnë të punojnë pa ndonjë dokument strategjik për luftimin dhe parandalimin e korrupsionit. Ndonëse një dokument i tillë ishte hartuar, mirëpo i njëjti ishte miratuar jashtëligjshëm nga Qeveria e Kosovës, duke i'a marrë kompetencat Kuvendit të Kosovës.
- Ndërsa Udhëzuesi për mbrojtjen që ju ofrohet personave që dorëzojnë raportimet në interes publik (sinjalizuesve) si dhe obligimet e punëdhënësve për të mbrojtur sinjalizuesit, të cilin do të duhej ta hartonte Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, nuk është hartuar ende, edhe pse i njëjti do të duhej të nxirrej në fund të vitit 2021.

9. Rekomandime

Bazuar në të gjeturat e këtij raporti, Lëvizja FOL jep këto rekomandime:

1. Të rritet buxheti i destinuar për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit në rishikimin e buxhetit për vitin 2023. Kjo rritje buxhetore do t'i mundësonte agjencisë t'i përmbushë obligimet e ngarkuara me ligjin e ri në mënyrë efektive, si dhe të përmbushë objektivat e saj në luftimin dhe parandalimin e korrupsionit. Të përmbushen
2. kërkesat e agjencisë për rritjen e numrit të stafit të agjencisë dhe për përmirësim të infrastrukturës së objektit të agjencisë.
3. Qeveria e Kosovës të ndërmarrë hapa të shpejtë në drejtim të finalizimit të Strategjisë Shtetërore për Parandalimin dhe Luftimin e Korrupsionit.
4. Ministria e Drejtësisë dhe Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit të finalizojnë Udhëzuesin për Mbrojtjen që ju ofrohet personave që dorëzojnë raportimet me interes publik (sinjalizuesve) si dhe obligimet e punëdhënësve për të mbrojtur sinjalizuesit.
5. Të ngritën kapacitetet profesionale të agjencisë dhe aspektet tjera të avancimit të zyrtarëve të agjencisë në trajtimin e rasteve të konfliktit të interesit, të sinjalizimit, si dhe të deklarimit të pasurisë përmes trajnimeve.
6. Të intensifikohet bashkëpunimi i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit me organet tjerat të sigurisë, prokurorinë dhe Njësinë e Inteligjencës Financiare. Me qëllim të maksimizimit të luftës kundër korrupsionit, Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit padyschim se i nevojitet mbështetja nga institucionet relevante të sistemit prokurorial dhe ai i hetimit financiar.

